

**MIRATOHET
MINISTRI
GENC RULI**

**RREGULLORE
PËR
PROCEDURAT E MIRATIMIT TË MARRËVESHJEVE
HIDROKARBURE DHE LIÇENSË MARRËVESHJEVE, SI DHE
AFATËT PËRKATËSE**

1. Kjo rregullore ka për objekt përcaktimin e procedurave të miratimit të marrëveshjeve hidrokarbure, liçensë marrëveshjeve, si dhe afatet përkatëse për miratimin e tyre.
2. Procedura për përgatitjen dhe miratimin e një Marrëveshje Hidrokarbure, nga AKBN dhe Albpetrol, sipas zonave që kanë në administrim, si dhe afatet kohore të miratimit të tyre, janë si më poshtë:
 - a. Subjekti i interesuar paraqet pranë AKBN apo Albpetrol-it një aplikim për të hyrë në Marrëveshje Hidrokarbure, këto të fundit duhet t'i paraqesin Ministrisë dokumentacionin e nevojshëm dhe kërkesën për miratimin e fillimit të negociimeve.

Afatet:

- AKBN apo Albpetrol do t'i paraqesë Ministrisë dokumentacionin e nevojshëm dhe kërkesën për miratimin e fillimit të negociimeve brenda 15 ditëve nga marrja e aplikimit.
 - Ministria do të jape aprovimin ose jo për fillimin e negociatave, brenda 10 ditëve nga marrja e kërkesës nga AKBN apo Albpetrol.
- b. Në rast miratimi, përfaqësuesit e AKBN apo Albpetrol fillojnë negociimin me subjektin e interesuar për Termat dhe Kushtet Kryesore të Marrëveshjes Hidrokarbure, në bazë të aplikimit të paraqitur nga subjekti i interesuar. Pasi bien dakort, dokumenti nënshkruhet nga të dy palet dhe i përcillet Ministrisë për miratim.

Afatet:

- AKBN apo Albpetrol do t'i përcjellë Ministrisë për miratim Termat dhe Kushtet Kryesore të Marrëveshjes brenda 10 ditëve nga data e nënshkrimit.

- Ministria do të japë miratimin apo refuzimin e saj për Termat dhe Kushtet Kryesore të Marrëveshjes brenda 10 diteve nga marrja e dokumentit të nënshkruar të Termave dhe Kushteve Kryesore të Marrëveshjes.
- c. Në rast miratimi të Termave dhe Kushteve Kryesore të Marrëveshjes Hidrokarbure, AKBN apo Albpetrol, fillojnë procesin e negocimit.

Procesi përfundon kur drafti përfundimtar firmoset në çdo faqe nga përfaqësuesit e AKBN apo Albpetrol dhe subjektit të interesuar.

- Drafti i përfunduar përkthehet në shqip dhe i përcillet Ministrisë për miratim.
- Në rast se AKBN apo Albpetrol gjykojnë të nevojshme, kryejnë opoenca, drafti rishikohet dhe i përcillet Ministrit për miratim.

Afatet:

- AKBN apo Albpetrol do të fillojnë negocimet brenda 30 ditëve nga marrja e miratimit për Termat dhe Kushtet Kryesore të Marrëveshjes Hidrokarbure.
 - AKBN apo Albpetrol do t'i përcjellë Ministrisë për miratim draftin përfundimtar të Marrëveshjes Hidrokarbure brenda 15 ditëve nga data e firmosjes së tij, në çdo faqe nga palët.
 - Kur drafti çohet për opoenca, atëhere rinegociimi dhe rishikimi i draftit bëhen brenda 20 ditëve nga data e marrjes së opoenca.
- d. Drafti i firmosur i Marrëveshjes Hidrokarbure, mund të dërgohet për opoenca nga Ministria, nëse e gjykon të nevojshme. Ministria e dërgon draftin për mendim në Ministrinë e Financave dhe Ministrinë e Drejtësisë.

Në rast vërejtjesh nga opoenca e kryer ose Ministrisë e sipërpërmendura dhe kur ato gjykohen si të drejta, drafti rinegocionet.

Pas kryerjes së rinegocimeve, Albpetrol e përcjell draftin e rinegociuar për miratim, ndërsa AKBN për miratim dhe nënshkrim, tek Ministri.

Afatet:

- Kur drafti çohet për opoenca, atëhere rinegociimi dhe rishikimi i draftit bëhet brenda 20 ditëve nga data e marrjes së opoenca.
 - Kur drafti çohet për mendim në Ministrinë e Financave dhe Ministrinë e Drejtësisë, atëhere rinegociimi dhe rishikimi i draftit bëhet brenda 20 ditëve nga data e marrjes së mendimit nga Ministrisë e mësipërme.
 - Drafti i rinegociuar dërgohet në Ministri brenda 10 ditëve.
 - Ministri është gati të nënshkruajë Marrëveshjen Hidrokarbure për zonat që administrojnë AKBN, brenda 10 ditësh.
 - Ministri jep miratimin për nënshkrimin e Marrëveshjes Hidrokarbure për zonat që administrojnë Albpetrol, brenda 10 ditëve. Albpetrol duhet të jetë gati për nënshkrimin e Marrëveshjes Hidrokarbure brenda 10 ditëve nga ky miratim.
- e. Me nënshkrimin e Marrëveshjes Hidrokarbure, ajo dërgohet për miratim përfundimtar në Këshillin e Ministrave.

3. Procedura për përgatitjen dhe miratimin e një Liçensë Marrëveshje, si dhe afatet kohore të miratimit të tyre, janë si më poshtë:
- a. Albpetrol paraqet prane AKBN kërkesën për t'u pajisur me Liçensë Marrëveshje nga Ministri, pas miratimit të Termave dhe Kushteve Kryesore të Marrëveshjes Hidrokarbure nga Ministria.

Afatet:

- Kërkesa paraqitet brenda 10 ditëve nga nënshkrimi i dokumentit të Termave dhe Kushteve Kryesore të Marrëveshjes Hidrokarbure.
- b. AKBN përgatit dhe i dërgon Albpetrol-it draftin e Liçensë Marrëveshjes. Drafti i Liçensë Marrëveshjes diskutohet mes Albpetrol-it dhe AKBN dhe përgatitet drafti përfundimtar që firmoset në çdo faqe. Drafti përfundimtar i paraqitet Ministrisë për miratim dhe nënshkrim.

Afatet:

- AKBN brenda 30 ditësh përgatit dhe i paraqet Albpetrol-it draftin e propozuar të Liçensë Marrëveshjes.
- Diskutimet për draftin përfundimtar kryhen brenda 50 ditësh.
- Drafti përfundimtar i paraqitet Ministrisë për miratim dhe nënshkrim brenda 10 ditëve.
- Ministri brenda 10 ditëve nënshkruan apo kërkon bërjen e ndryshimeve.
- Në rast se Ministri kërkon ndryshimin e draftit, ato kryhen brenda 30 ditëve dhe drafti i rishikuar i Liçensë Marrëveshjes riparaqitet për nënshkrim.
- Liçensë Marrëveshja nënshkruhet nga Ministri dhe Albpetrol brenda 10 ditësh, pasi është dhënë miratimi për Marrëveshjen Hidrokarbure.